



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

UDHËZUES PËR MARKETING FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

27.09.2018, Prishtinë

Kosovo Basketball Federation, Lagjja "Arbëria", Bloku C3/(Faza 2), Rr. Radovan Zogoviq, Hyrja 7 10000 Prishtinë,
Kosovë

ëëë.basketbolli.com, email: info@basketbolli.com, tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080

ARTMOTION



Spitali Amerikan



RACI UETIKA E KOSOVËS
INSTITUCIONALIZIMI I UETIKËS
2008-2018



BAKER TILLY
KOSOVO

automita



kutia



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

1. Dispozitat e Përgjithshme	3
1.1 Hyrje	3
1.2 Obligimet e FBK-së	3
1.3 Brendimi.....	4
1.4 Personi kontaktues në FBK.....	4
1.5 Obligimet e skuadrave.....	4
1.6 Personat kontaktues nga skuadrat.....	4
1.7 Mosrespektimi i udhëzuesit dhe masat ndëshkuese.....	5
2. Annex 1.....	6

Kosovo Basketball Federation, Lagjja "Arbëria", Bloku C3/(Faza 2), Rr. Radovan Zogoviq, Hyrja 7 10000 Prishtinë,
Kosovë

ëëë.basketbolli.com, email: info@basketbolli.com, tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080

ARTMOTION



Spitali Amerikan



REPUBLIKA E KOSOVËS



BAKER TILLY
KOSOVO



kutia



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

1. Dispozitat e Përgjithshme

1.1. Hyrje

Nëpërmjet këtij udhëzuesi definoohen të gjitha kërkesat dhe kriteret themelore që dalin nga Marrëveshja për Sponsorizim e nënshkruar ndërmjet Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) dhe kompanisë Art Motion më 30.08.2018 në Prishtinë, si dhe nga Rregullorja mbi të Drejtat dhe Transmetimet Audio Vizuale e miratuar nga Bordi i FBK-së më 06.09.2018.

1.2. Obligimet e FBK-së

Në bazë të marrëveshjes së nënshkruar nga FBK dhe Art Motion gjysma e hapësirës kohore të marketingut gjatë transmetimit të të gjitha ndeshjeve i takon FBK-së, qoftë në televizion qoftë në internet, përfshirë këtu hapësirën reklamuese gjatë time-out, mes çerekëve, mes pjesëlojës së parë dhe të dytë dhe gjatë të gjitha ndërprerjeve tjera të lojës.

Po ashtu në bazë të kësaj marrëveshje FBK mund dhe do ta ndaj hapësirën e vet reklamuese për reklamimin e sponsorëve apo veprimtarisë së vet, por edhe të klubeve anëtare të saj me kusht që ndarja e hapësirës reklamuese nga ana e FBK-së të bëhet në mënyrë transparente dhe duke shmangur uljen e mundshme të çmimit të hapësirës së marketingut.

Ndarja e hapësirës reklamuese do të bëhet si në vijim:

- 450 sekonda i takojnë në përgjithësi FBK-së;
- Prej këtyre 450 sekondave, 225 sekonda i takojnë ekipit nikoqir, 112,5 sekonda i takojnë ekipit mysafir dhe 112,5 sekonda i takojnë FBK-së;
- Çmimi për reklamat gjatë ndeshjeve të FBK-së duhet të jetë 3.00 (tri) Euro.

Theksim: Në hapësirën reklamuese kanë qasje të gjitha klubet e Superligës së Kosovës, derisa ato ekipet e Ligës së Femrave, Ligës së Parë apo edhe kategorive të reja do të kenë qasje

Kosovo Basketball Federation, Lagjia "Arbëria", Bloku C3/(Faza 2), Rr. Radovan Zogoviq, Hyrja 7 10000 Prishtinë,
Kosovë

ëëë.basketbolli.com, email: info@basketbolli.com, tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080

ARTMOTION





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

vetëm në rastet kur ndeshjet e tyre do të transmetohen drejtëpërdrejtë apo edhe do të shfaqen në njërin nga kanalet e Art Sport.

Të gjitha ndeshjet që transmetohen drejtëpërdrejtë dhe ato që incizohen, FBK do t'i vendos në kanalin e saj në Youtube.

1.3 Brendimi

FBK po ashtu është e obliguar në bazë të marrëveshjes me Art Motion që në 11 palestrat sportive ku do të zhvillohen ndeshjet sportive në kuadër të FBK-së të vendos panon reklamuese statike me dimension 3x1m, me logon e Art Motion apo logot e produkteve të preferuara dhe parapërcaktuara nga Sponsor, para tavolinës zyrtare, për të gjitha ndeshjet e Superligës, si dhe për të gjitha ndeshjet e ligave dhe garave tjera me transmetim televiziv apo në internet.

Rreth fushës duhet të vendosen 2 reklama statike (3m x 1m) të cilat i takojnë Art Motion dhe Devolli Corporation të pozicionuara në pozitën B, pas koshave. Këto i prodhon Art Motion dhe duhet të vendosen në të gjitha palestrat ku luhen ndeshjet në kuadër të FBK-së. Pas dorëzimit nga Art Motion, përgjegjës për këto reklama janë vetë klubet.

1.4 Personi kontaktues në FBK

Personi kontaktues në FBK për të zbatuar në tërësi gjithçka që i përket marrëveshjes në mes FBK-së dhe Art Motion është Vullnet Sylja, Zyrtar për Marketing në FBK.

Vullnet Sylja do të jetë pikë kontakti në mes FBK-së, klubeve anëtare të saj dhe Art Motion.

1.5. Obligimet e skuadrave

Skuadrat janë të obliguara që të zbatojnë në tërësi udhëzuesin për marketing të FBK-së, dhe të bashkëpunojnë ngushtë me zyrtarin për marketing të FBK-së.

Kosovo Basketball Federation, Lagja "Arbëria", Bloku C3/(Faza 2), Rr. Radovan Zogoviq, Hyrja 7 10000 Prishtinë, Kosovë

ëëë.basketbolli.com, email: info@basketbolli.com, tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080

ARTMOTION





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Skuadrat janë të obliguara që panot reklamuese të përgatitura nga FBK me logo të Art Motion ti vendosin para tavolinës zyrtare apo përballë saj, varësisht si e kërkon Art Motion. Skuadrat janë të obliguara që dy ditë para ndeshjes t'i dorëzojnë në FBK reklamamat që planifikojnë ti përdorin për ndeshjen e radhës.

1.6. Personat kontaktues nga skuadrat

Ekipet anëtare të FBK-së janë të obliguara që të caktojnë një person përgjegjës për marketing, i cili do të jetë pikë kontaktuese për FBK-në për të zbatuar në tërësi dispozitat e përgjithshme që dalin nga ky udhëzues.

1.7. Mosrespektimi i udhëzuesit dhe masat ndëshkuese

FBK në këtë udhëzues ka paraparë edhe masat ndëshkuese për klubet që nuk i respektojnë dispozitat e përgjithshme.

Në rast të mosrespektimit të udhëzuesit të marketingut, FBK ka paraparë të ndëshkojë klubet me 10% të shumës së kootizimit dhe licencimit në FBK për një veprim, por nëse i njëjti veprim përsëritet, atëherë përqindja do të dyfishohet për herën e dytë, pra 20% dhe kështu do të vazhdojë që ndëshkimi gjithnjë të rritet për 10%.

Kosovo Basketball Federation, Lagjja "Arbëria", Bloku C3/(Faza 2), Rr. Radovan Zogoviq, Hyrja 7 10000 Prishtinë,
Kosovë

ëëë.basketbolli.com, email: info@basketbolli.com, tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080

ARTMOTION





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

2.

Annex 1

Nëpërmjet këtij udhëzuesi FBK njofton të gjitha klubet anëtare të saj se person përgjegjës për komunikimin ndërmjet skuadrave dhe FBK-së në lidhje me caktimin e termineve është Komesari i Garave të FBK-së dhe Komesari i Garave të Kategorive të Reja.

Pra i gjithë komunikimi për çdo gjë që ka të bëjë për orare të zhvillimit/transmetimit të ndeshjeve duhet të kryhet nëpërmjet dy Komesarëve, pra FBK-së dhe klubeve, dhe jo klube-Art Motion.

Po ashtu FBK njofton të gjitha klubet e Superligës së Kosovës se oraret për zhvillim të ndeshjeve prej xhiros së dytë e tutje do të jenë në ora 17:00 dhe 19:00, kurse atëherë kur ndeshjet zhvillohen gjatë ditëve të javës, atëherë ndeshjet do të luhen në ora 19:00.

Elvira Dushku
Sekretare e Përgjithshme

27.09.2018, Prishtinë

Federata e Basketbollit të Kosovës



Kosovo Basketball Federation, Lagjja "Arbëria", Bloku C3/(Faza 2), Rr. Radovan Zogoviq, Hyrja 7 10000 Prishtinë,
Kosovë

ëëë.basketbolli.com, email: info@basketbolli.com, tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080

ARTMOTION



Spitali Amerikan



REGJERIA E KOSOVËS



BAKER TILLY
KOSOVO



automita



kutia